



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" Prizrenit
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" of Prizren
Univerziteti Prizren
"UKSHIN HOTI"

KËSHILLI DREJTUES

Pranuar qe dt.	16.06.2023
Zyra e pranimit	Iir. i protokolit
308	01-367

Rruga e Shkronjave nr.1 20 000 Prizren-Kosovë ; Tel :+383 (0) 29 232 140 ; Homepahe :www.uni-prizren.com

Këshilli Drejtues

nr. ref. _____

Prizren, më 16.06.2023

Bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit nr. 04-V-621 të datës 30.05.2013, vendimet e KD-së, rregulloren nr. 01-34 për zgjedhjet e studentëve në Universitetin "Ukshin Hoti", Këshilli Drejtues, në takimin e mbajtur më datën 16.06.2023, në lidhje me organizimin e procesit të zgjedhjeve studentore, nxjerr këtë:

V E N D I M

- Plotësohet – ndryshohet Rregullorja për zgjedhjet e studentëve të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, nr. 01-34, dt. 09.02.2018, si në vijim:
 - **Neni 13:**
Riformulohet pika 1 si në vijim: 1. Për secilin fakultet të UPZ-së themelohet komisioni i zgjedhjeve nga Komisioni Zgjedhor brenda pesë ditëve pas themelimit. Në rastet kur zgjedhjet mbahen në formë elektronike nuk themelohen fare KZF-të pasi punën e tyre në tërësi e kryen Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU).
 - **Neni 30:**
I shtohet pika 3. Zgjedhjet mund të organizohen edhe në mënyrë elektronike, përmes Sistemit të Menaxhimit Universitar (SMU). Procedurat dhe mënyra e votimit përmes këtij sistemi përcaktohet nga KOZ në bashkëpunim me përfaqësuesit e autorizuar të SMU-së dhe zyrën e IT-së.
 - **Neni 45:**
I shtohet pika 5. Në rastet kur zgjedhjet mbahen në formë elektronike, Komisioni Qendror Zgjedhor e pranon rezultatin e votimit së bashku me raportin përmbledhës të procesit zgjedhor për secilin fakultet në formë elektronike nga SMU.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Me qëllim kryesor kryerjen e punëve dhe detyrave të punës në mënyrë efikase dhe efektive brenda dinamikës së zgjedhjeve duke u bazuar në dispozitat e rregullores nr. 01-34 dhe legjislacionit tjetër në fuqi, për shkak të ekonomizimit të procesit zgjedhor si dhe duke ju referuar praktikave të disa universiteteve tjera publike në vend në lidhje me organizimin e zgjedhjeve studentore në mënyrë elektronike, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- MASHTI-t
- Këshillit Drejtues të UUHP
- Menaxhmentit të UUHP,
- Sekretarit të Përgjithshëm të UUHP
- Zyrës Ligjore të UUHP dhe
- Arkivit

Prof. Asoc. Dr. Arif M. ...
Kryesues i Këshillit Drejtues